



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01.Nr. 106/02-25942/23
Kaçanik 03.10.2023

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit nr.03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale; nenit 21, pika 2 dhe nenit 131, pika 5, të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative nr. 05/L-031; nenit 73 të Statutit të Komunës së Kaçanikut, Kryetari i Komunës së Kaçanikut merr këtë:

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E ANKESËS SË NDËRMARRJES "2 KORRIKU" SH.P.K., me NR. 06-351/01-25460/23

1. Me këtë Vendim, formohet Komisioni për shqyrtimin e Ankesës së Ndërmarrjes "2 Korriku" Sh.p.k., në lidhje me Vendimin e Drejtorisë së Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, me nr.06-351/01-24936/23, sipas të cilit është anuluar Vendimi i po kësaj I po kësaj Drejtorie me nr.06-351/02-27108/23, i datës 30.09.2021, për Lejen e legalizimit për përfundimin e ndërtimit.
2. Komisioni ka këtë përbërje:
 - 2.1. Besmir Krasniqi,
 - 2.2. Gentiana Sallahu,
 - 2.3. Rakip Vishi,
 - 2.4. Ilir Krivanjeva
 - 2.5. Festim Neziraj
3. Detyra dhe Përgjegjësia e këtij komisioni është të shqyrtojë Ankesën e Ndërmarrjes "2 Korriku" Sh.p.k. dhe ti jep një përgjigje të qartë Kryetarit të Komunës dhe palës, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi..
4. Ky Vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e Kryetarit të Komunës.

Vendimi u dërgohet:


1. Kryetarit të Komunës,
2. Anëtarëve të Komisionit, dhe
3. Arkivit.



Kryetari i Komunës
Besim Ilazi



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipality of Kaçanik

Zyra e Kryetarit

01Nr. 104/03-27423/23
Kaçanik, 20.10.2023

Në mbështetje të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/15 qershor 2008), pas propozimit të Koordinatorës së projekteve në CDF (Community Development Fund), Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

Për formimin e komisionit për vlerësimin e nëngranteve për projektin "Komuna për të Rinjtë"- cikli i dytë

- I. Me këtë vendim formohet komisioni për vlerësimin e nëngranteve për projektin "Komunat për të Rinjtë"- cikli i dytë.
- II. Komisioni do të jetë me këtë përbërje:
 1. Sadat Koxha -zyrtarë i pasurisë (kryesues);
 2. Qëndresa Hyseni- shoqëria civile;
 3. Florinda Hasani-studente;
 4. Ibush Vishi-pensionist;
 5. Enver Kamishi-profesor.
- III. Komisioni ka për detyrë që të vlerësoj aplikacionet për nëngrantet për projektin "Komuna për të rinjtë "- cikli i dytë.
- IV. Për punën e vet komisioni harton një raport me shkrim, me të cilin njofton Kryetarin e Komunës.
- V. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Me këtë vendim, njoftohen:

1. Anëtarët e Komisionit;
2. MAPL-në;
3. CDF;
4. Arkivi.



Kryetari i Komunës
Besim Ilazi